

V E N D I M
Nr. 474, datë 19.7.2001

**PËR RITJEN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË TEKSTEVE SHKOLLORE TË
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992, "Për çmimet dhe tarifat", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çmimet e shitjes me pakicë të teksteve të arsimit parauniversitar të rriten mesatarisht 15 për qind për tekstet e arsimit tetëvjeçar dhe 25 për qind për tekstet e arsimit të mesëm, kundrejt çmimeve të tyre, me pakicë në fuqi, të miratuar me vendimin nr. 438, datë 15.9.1999 të Këshillit të Ministrave "Për rritjen e çmimeve të shitjes me pakicë, të teksteve të arsimit shkollor, parauniversitar".

2. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të llogarisë titull për titull, çmimet e reja të teksteve shkollore dhe t'i shpallë ato për zbatim menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi. Këto çmime të zbatohen për të gjitha tekstet shkollore të arsimit parauniversitar, që janë në gjendje të prodhuara apo në qarkullim, si dhe për ato që do vazhdojnë të shtypen, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Diferencat ndërmjet çmimeve të reja dhe atyre të mëparshme, për sasitë e shtypura, gjendje apo në qarkullim, pranë subjekteve përkatëse të shitjes me pakicë, me efekt financiar prej rreth 7 000 000 (shtatë milionë) lekësh, të grumbullohen dhe të përdoren nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për shtypjen e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar gjatë vitit 2001.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të ndjekin dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e rregullt të inventarizimeve, për sistemimin e diferencave të çmimeve të teksteve, gjendje të prodhuara dhe derdhjen e tyre nga subjekti, që i zotëron për llogari të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, gradualisht me shitjen me çmimet e reja, deri në fund të muajit nëntor 2001.

5. Diferencat ndërmjet shpenzimeve të prodhimit e të shpërndarjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar dhe të çmimeve përkatëse të shitjes me pakicë të tyre, të caktuara sipas këtij vendimi, të vazhdojnë të subvencionohen nga Buxheti i Shtetit, sipas shumës vjetore përkatëse, të miratuar në Buxhetin e Shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta